



**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 172, Datë 03.08.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “URADRIN” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “URADRIN” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 455, datë 15.06.2018, shoqëria “URADRIN” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 153, datë 03.07.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “URADRIN” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/48 Prot., datë 03.07.2018, u bë njoftimi në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 455/1 Prot., datë 11.07.2018, iu kërkuar subjektit të plotësojë dokumentacionin e munguar i cili konsiston në vërtetimin e prokurorisë.
- Subjekti “URADRIN” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 455/3 Prot., datë 17.07.2018, paraqiti në ERE dokumentacionin e munguar.
- Në përfundim të afatit 10 ditë pune, të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë

vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “URADRIN” sh.p.k, për licensim ne aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “URADRIN” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
  - Formati dhe Dokumentacioni për aplikim (neni 9 pika 1)
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)
  - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3)
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “URADRIN” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.